



NË KËTË NUMËR:

<i>Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik primar për vendin</i>	2-3
<i>Studentët mbajtën praktikën në терминаlet doganore</i>	4
<i>U botua libri "E drejta doganore" i prof. Orhan Çekut</i>	5
<i>Studentët prezantuan hulumtimet</i>	6
<i>Vizitë pikave kulturo-historike e turistike</i>	7
<i>Themeluesi i "Pjetër Budi" shtroi darkë për stafin e Kolegjit</i>	8

dhe të tjera...

Zhvillimi i qëndrueshëm

Shteti i Kosovës duhet të punojë që të krijojë mjedis të favorshëm për zhvillimin e biznesit, tërheqjen e investimeve të huaja dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Në këtë kontekst, Dogana e ka rolin e vet të rëndësishëm, si institucion i zbatimit të ligjit. Kështu u tha gjatë tryezës debatuase “Roli i doganave në proceset integruese”, të organizuar nga Kolegji “Pjetër Budi”, Prishtinë, më 26 janar.

Deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri të Kuvendit të Kosovës tha se vendi duhet të ketë ekonomi konkurrenente dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Sipas tij, zhvillimi ekonomik i vendit është më primar sesa liberalizimi i vizave. Ndërkaq, si sfida për Doganën e Kosovës, Mustafa përmendi mbrojtjen nga politizimi, luftimin e kriminalitetit, mbrojtjen e interesit publik, zbatimin e kontrollit në tërë territorin e vendit dhe mbrojtjen e konkurrencës fer.

Safet Gërxfhaliu, kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës theksoi se Dogana nuk është vetëm komponentë ekonomike, por edhe politike, sociale e edukuese, ndërkaq ka edhe karakter integrues. Sipas tij, katër sfidat kryesore të shtetit të Kosovës janë Evropa, edukimi, ekonomia dhe ambientalizmi.

Ismail Mehmeti, ligjërues në Kolegjin “Pjetër Budi” dhe udhëheqës i Programit Studimor Doganë dhe Shpeditacion tha se Dogana e Kosovës është në mesin e institucioneve të zbatimit të ligjit që ka performuar më së miri në vendin tonë në periudhën e pasluftës.





ekonomik primar për vendin

“Dogana e Kosovës ka krijuar marrëdhënie partneriteti me shumë institucione doganore në regjion dhe më gjerë, duke qenë faktor me rëndësi integrues i vendit tonë”, theksoi Mehmeti.

Sipas tij, Dogana si institucion i zbatimit të ligjit determinon rrugën integruese të vendit nëpërmjet zbatimit të politikave ekonomike-tregtare, të cilat i harton qeveria.

Elez Sylja, kyetar i Shoqatës së Agjencioneve Doganore të Kosovës pati qasje kritike ndaj punës së Doganës, kurse Orhan Çeku, ligjërues në Kolegjin “Pjetër Budi” theksoi se ky institucion i arsimit universitar, si i vetmi institucion shqipfolës në Ballkan që ofron studime universitare për Doganë dhe Shpeditcion, kontribuon në përgatitjen e kuadrove të profesionalizuar në fusha specifike dhe të domosdoshme për zhvillim ekonomik të vendit.



Në emër të Kolegjit “Pjetër Budi”, pjesëmarrësit i përshëndeti Evliana Berani, prodekane për Çështje Akademike. Tryeza debatuuese u organizua me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Doganave. Ligjëruesi Ismail Mehmeti tha se kjo ditë reflekton standarde që Organizata Botërore e Doganave i ka vendosur dhe duhet të plotësohen nga doganat e vendeve anëtare dhe atyre që pretendojnë të jenë vende anëtare, siç është rasti i Kosovës. Në vitin 1953 në Bruksel është mbajtur seanca konstituive e Këshillit për Kooperim Doganor. Në seancën inauguruese kanë marrë pjesë përfaqësuesit e 17 vendeve themeluese. Ky institucion në vitin 1994 ndryshoi emërtimin dhe tash quhet Organizata Botërore e Doganave. 26 Janari çdo vit shënohet si Dita Ndërkombëtare e Doganave.

Studentët mbajtën praktikën në терминаlet doganore

Grupi i dytë i studentëve të vitit të tretë të drejtimit Doganë dhe Shpeditcion të Kolegjit “Pjetër Budi” ka përfunduar praktikën në терминаlet doganore të Republikës së Kosovës. Ata ishin të shpërndarë në терминаlet në Ferizaj, Han të Elezit, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë, Prizren dhe Intereuropa për të parë nga afër punën që zhvillohet aty. Gjatë ditëve sa ka zgjatur praktika, studentët kanë pasur rastin që të shohin dhe kuptojnë se si fillon organizimi i transportit ndërkombëtar të mallrave (të gjitha llojet dhe rrugët transportuese), cilat janë procedurat doganore në kufi (pikëkalime kufitare të mallrave), cilat janë procedurat dhe dokumentacioni përkatës në arritje në ZBD (zyrë të brendshme doganore), procedurat e strehimit doganor dhe vendosja e mallrave nën mbikëqyrje doganore (sistemi i evidencës dhe raportimit), zhdoganimi, zhdoganimi parcial, reeksporti, strehimi doganor i produkteve farmaceutike, lëshimi i mallrave në qarkullim të lirë etj. Praktika doganore është pjesë e rëndësishme e punës së studentëve gjatë studimeve në Doganë dhe Shpeditcion.





U botua libri “E drejta doganore” i prof. Orhan Çekut

Me qëllim të pasurimit të literaturës profesionale në lëmin e doganës dhe shpedicionit, Kolegji “Pjetër Budi” ka botuar tekstin “E Drejta Doganore”, të autorit Dr. Orhan Çeku. Libri “E Drejta Doganore” ka për qëllim të plotësojë nevojën për tekst universitar nga kjo lëndë, e cila është paraparë me planprogramin e Programit Studimor Doganë dhe Shpedicion në Kolegjin “Pjetër Budi”, Prishtinë.



Ky libër u kushtohet në radhë të parë studentëve të Kolegjit “Pjetër Budi”, gjithashtu edhe studentëve të Fakultetit Juridik, si dhe studiuesve të ndryshëm, por është i përshtatshëm edhe për punonjësit në sistemin doganor në Republikën e Kosovës dhe subjektet që merren me afarizmin dhe tregtinë ndërkombëtare. Ky tekst universitar është i pari i këtij lloji në vend dhe ky fakt mjafton për të treguar domosdoshmërinë e botimit të tij.

“E Drejta Doganore” është ndarë në disa pjesë, si: kuptimi i nocionit dhe historiku i doganave, objekti dhe metodat e studimit të së drejtës doganore, institucionet e të drejtës doganore, burimet juridike, subjektet e të drejtës doganore, sistemi doganor në Republikën e Kosovës, marrëdhëniet e punës në administratën doganore, kriminaliteti doganor, e drejta doganore e Unionit Evropian dhe e drejta procedurale administrative doganore.

Autori i librit, Dr. Orhan Çeku, njëherësh profesor në Kolegjin “Pjetër Budi” theksoi se ky tekst është fryt i punës disavjeçare dhe ka rrjedhur nga kërkesa e parashtruar vazhdimisht prej studentëve për të pasur një tekst gjithëpërfshirës për këtë fushë.

Studentët prezantuan hulumtimet

Studentët e vitit të tretë të drejtimeve Doganë e Shpediton dhe Administrim Biznesi të Kolegjit “Pjetër Budi” prezantuan hulumtimet e realizuara në terren, në kuadër të lëndës Shkrim Akademik. Në prani edhe të stafit të kolegjit, ata paraqitën punën e tyre në realizimin e hulumtimeve që në fokus kishin tema të ndryshme – që nga përdorimi i rrjeteve sociale nga moshat më të vjetra dhe konsumimi i produkteve vendore, deri te problemet e furnizimit me ujë, gjendja sociale të personave të moshuar, përdorimi i telefomave të mençur dhe mungesa e shtigjeve për biçikleta në Prishtinë. Hulumtimet u vlerësuan pozitivisht.




SONDAZH: Festat e fundvitit shumica i kaluan në shtëpi

Festat e fundvitit i kanë kaluar në shtëpi, sepse nuk kanë pasur mundësi të tjera. Kështu janë deklaruar shumica (rreth 74 për qind) e të anketuarve në një sondazh të realizuar nga Kolegji “Pjetër Budi”. Jashtë shtëpisë, në organizime publike, kanë festuar rreth 16 për qind (15.8 %), ndërkohë për të festuar jashtë vendit (sepse kanë pasur mundësi financiare) kanë zgjedhur 10.5 për qind e të anketuarve.

Ku do t'i kaloni festat e fundvitit?

■ Në Shtëpi ■ Jashtë shtëpisë, në organizime publike ■ Jashtë vendit





Vizitë pikave kulturo-historike e turistike



Studentët e Menaxhmentit Master (Menaxhimi i Turimit dhe Hotelerisë) të Kolegjit “Pjetër Budi” kanë zhvilluar një vizitë edhe në Liqenin e Batllavës dhe në Kompleksin Memorial “Zahir Pajaziti” në Orllan. Bashkë me profesorin Zija Zimeri ata kanë parë në praktikë dhe diskutuar për ofertën turistike në funksion të zhvillimit të llojeve turistike: kulturor-historik, malor, liqenor e hotelier.

Studentët e “Pjetër Budit” vizituan Muzeun e Kristaleve dhe Mineraleve

Studentët e Menaxhmentit Master (Menaxhimi i Turimit dhe Hotelerisë) të Kolegjit “Pjetër Budi” kanë zhvilluar një vizitë në Muzeun Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve “Trepça” në Mitrovicë. Të shoqëruar nga profesori Zija Zimeri, ata janë njoftuar me historikun e muzeut që është themeluar si domosdoshmëri për ruajtjen dhe promovimin e pasurive nëntokësore që shfaqen në formën më të bukur natyrale, nëpërmjet kristaleve të “Trepçës”.

Muzeu ka për qëllim hulumtimin, mbrojtjen, konservimin, restaurimin trajtimin, studimin, inventarizimin dhe katalogimin informatik të objekteve, mineraleve/kristaleve dhe dokumentacionit që gjendet në muze. Ky muze, vazhdimësi e atij të vjetrit që ka funksionuar për gati gjysmë shekulli, është përruar në qershor të viti 2012 dhe është krijuar me fonde të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe ndërmarrjes “Trepça” me një vlerë prej 560 mijë eurosh.



Themeluesi i “Pjetër Budi” shtroi darkë për stafin e Kolegjit

Me rastin e përfundimit të semestrit dimëror të vitit akademik 2014/2015 dhe fillimit të vitit të dhjetë jubilar të punës së “Pjetër Budit”, themeluesi i Kolegjit, z. Besim Ajeti ka shtruar darkë për stafin akademik dhe administrativ të institucionit. Me këtë rast, prodekanja për Çështje Akadematike, Evliana Berani ka falënderuar të gjithë të pranishmit, të cilët kanë kontribuar që “Pjetër Budi” të përfundojë suksesshëm dekadën e parë të punës, ndërkaq prof. Ibish Mazreku e ka ndarë me të gjithë përvojën e tij, si pjesë e këtij institucioni të arsimit universitar thuajse që nga themelimi. Kolegji “Pjetër Budi” është themeluar në vitin 2005 dhe shquhet për programe akademike zhvillimore dhe specifike jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë.

